



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18.4.2023

Nr: 370

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË SHOQËRISË “DIASPORA SHQIPTARE” DHE QENDRËS RINORE
“H.A.N.A”, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot në datën 18.4.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat me:

KËRKUES: Shoqëria “Diaspora Shqiptare”, me seli në Tiranë dhe me përfaqësues z. Thanas Moçka,

Qendra rinore “H.A.N.A”, me adresë rruga “Luigj Gurakuqi”, pallati 130, Lezhë dhe me përfaqësues zj. Besmira Lekaj.

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

V Ë R E J:

Shoqëria “Diaspora Shqiptare” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 3 (tre) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Data: 18.4.2023 Nr: 370
Ora: 10:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të shoqërisë “Diaspora Shqiptare” dhe Qendrës Rinore “H.A.N.A”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.”

Shoqëria “Diaspora Shqiptare” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Qendra rinore “H.A.N.A”, i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 7 (shtatë) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Qendra rinore “H.A.N.A” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S:

1. Akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër të shoqërisë “Diaspora Shqiptare” për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër të qendrës rinore “H.A.N.A” për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 18.4.2023 Nr: 370
Ora: 10:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të shoqërisë “Diaspora Shqiptare” dhe Qendrës Rinore “H.A.N.A”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.”